



**KONTRATË ME TRANSFERIM
PJESËRISHT TË AKTIVITETIT/ASETEVE**
TË SHOQËRISË “EMANTE “SHPK TEK SHOQËRIA “ISOTECK ITALBA” SHPK
—në bazë të nenit 705 të k.civil dhe ligjit për tvsh nr.92/2014 datë 24/07/2014 neni 16—

Sot më datë 24 Tetor 2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë) ditën e enjte, para meje Noterit **Sokol Sh. MALAJ**, Noter në Degën Vendore të Noterisë Tiranë, me seli në Rr “L.Gurakuqi”, Pallat i ri, u paraqitën personalisht:—

PALA I:

Shoqëria “**E M A N T E**” shpk është regjistruar si person juridik pranë QKB më datë 24.02.2006 me Nr Unik të Identifikimit të subjektit NIPT- **K61612002U**, e cila ndodhet me seli në Tiranë, Vorë, Muçaj, Rruga Industriale, Nd 61, e cila në bazë të Vendimit Nr 1 të Ortakut të Vetëm **Z. HEKURAN BRAHIMAJ** i biri i Rustem dhe Qelibare lindur në Katundisht, Përmet më 13.08.1972 banues në Vorë, Tiranë, i paisur me Kartën e Identitetit #031162491# me nr.Personal #H20813103N#, vërtetuar kjo me Vërtetimin Noterial me Nr.2191REP të datës 24.10.2019, akt i hartuar/ noterizuar nga Noter Sokol Sh. MALAJ, përfaqësohet në këtë akt noterial nga Administratorja **Znj. FLUTURA BRAHIMAJ** e bija e Ndrekos dhe Kates lindur në Sarande më 15.01.1982 banuese në Vorë, Tiranë, e paisur me Kartën e Identitetit me nr.Personal #I25115086S#.—

PALA II:

Shoqëria “**ISOTECK ITALBA**” shpk është regjistruar si person juridik pranë QKB më datë 20.10.2017 me Nr Unik të Identifikimit të subjektit NIPT- **L72220506A**, e cila ndodhet me seli në Durrës, Rrashbull, Zona Kadastrale 1198, Pasuria 64/16, e cila në bazë të Vendimit Nr 3 të Ortakëve vërtetuar kjo me Vërtetimin Noterial me Nr.2194REP të datës 24.10.2019 akt i hartuar/ noterizuar nga Noter Sokol Sh. MALAJ, përfaqësohet në këtë akt noterial nga Administratorët **Z. HEKURAN BRAHIMAJ** i biri i Rustem dhe Qelibare lindur në Katundisht, Përmet më 13.08.1972 banues në Vorë, Tiranë, i paisur me Kartën e Identitetit #031162491# me nr.Personal #H20813103N# dhe **Z. FRANCESCO GENTILE** i biri i Pasquale dhe Anna lindur në Bitonto (BA), më 20.02.1953, banues në Itali Via Cordasco Nr.6, i identifikuar me Pasaportën YA9553140.—

Z. FRANCESCO GENTILE deklaron se nuk e kupton gjuhën shqipe dhe asistohet në këtë akt në gjuhën italiane nga Përkthyesja e licencuar **Znj. VJOLLCA META** e bija e Ismail dhe Pashe lindur në Mat më 24.01.1973 banues në Tiranë Rr. Dali Ndreu Pall 13 ap 7, e pajisur me kartën e identitetit # 029116719#, me Nr personal #H35124072B#.—

Të lartpërmendurit janë madhorë me zotësi të plotë juridike për të vepruar të cilët deklaruan se lidhin Kontratën e transferimit të veprimtarisë “Prodhim Panele Sanduiç” me kushtet si vijon: —

PALA I-rë (Shoqëria “**E M A N T E**” shpk përfaqësuar nga Administratorja **Znj.FLUTURA BRAHIMAJ**) në njohje të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë deklaron se është pronare e veprimtarisë “*Import-eksport, tregti te materialeve ndertimore, panele, profile hekuri dhe plastik, import eksport dhe tregetim me shumice dhe pakice te mallrave industriale, ushqimore, blegtorale, bujqesore, matreiale te ndertimit etj. Përpunim të llamarinës kryesisht prodhim aksesore llamarine. Prodhimi, montimi dhe sherbimi i vendosjes se kioskava me panele sanduiç.: Import-eksport i elektroshtepiakeve, hidrosanitareve, mobiljeve, elektrikeve, kondicionereve, paisjeve te palestrës, artikuj sportiv, linoleum inxhinierik si dhe lende druri. Tregti me shumice dhe pakice i elektroshtepiakeve, hidrosanitareve, mobiljeve, elektrikeve, kondicionereve, paisjeve te palestrës, artikuj sportiv, linoleum inxhinierik si dhe lende druri. Transportimi i materialeve ndërtimore, panele, profile hekuri dhe plastike, mallrave industriale, ushqimore, blegtorale, bujqe'sore, i elektroshtepiakëve, hidrosanitareve, mobiljeve, elektrikeve, kondicionereve, paisjeve të palestrës, artikuj sportiv, linoleum inxhinierik, lënde druri si dhe të kioskave me panele sanduich.*” (sipas Ekstartit të kësaj Shoqërie).—

Palët, në marrëveshje të përbashkët të arritur jashtë kësaj Zyre; kanë rënë dakord që nje pjesë e aseteve të shoqërisë “**E M A N T E**” shpk t’i transferohet, **Palës së II-të**, pra **Shoqërisë “ISOTECK ITALBA” sh.p.k.**—

Transferimi i këtij aktiviteti bëhet sipas ligjit për TVSh Nr.92/2014 datë 24/07/2014 Neni 16.—

Për kryerjen e aktivitetit tregëtar, Shoqëria ka në pronësi edhe pasurinë e paluajtshme konkretisht:

- **Ndërtesë Industriale për Fabrikë Prodhimi e Panele Sandwich me sipërfaqe 4749m²** (katër mijë e shtatëqind e dyzet e nëntë metra katrorë) e ndodhur në Bisht Kamëz, Durrës, e ndërtuar në bazë të Lejes së Zhvillimit me Nr 626 datë 23.10.2017 në vlerën 134.816.740 All (njëqind e tridhjetë e katër milionë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e dyzet Lekë) të cilën kërkon ta transferojë në asete të shoqërisë “**ISOTECK ITALBA**” shpk.

Kjo ndërtesë ndodhet në pasurinë e paluajtshme:

- **Tokë –ARË me sipërfaqe 19.889m²** (nëntëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë metra katrorë), regjistruar me Nr pasurie 64/16, Volumi 1, Faqe 134, Zona Kadastrale 1198, regjistruar në emër të shoqërisë “**E M A N T E**” shpk, vërtetuar kjo me Çertifikatën për Vërtetim pronësie me Nr serial 1532778 datë 16.05.2017, e cila është në vlerën 29.609.800 All (njëzet e nëntë milionë e gjashtëqind e nëntë

mijë e tetëqind Lekë), me kushtin që kjo pasuri (Toka) të kalojë në kapital të shoqërisë "ISOTECK ITALBA" shpk, si kontribut në natyrë i shoqërisë "E M A N T E" shpk.—

- Huanë e dhënë në shumën 125.440.048 All (njëqind e njëzet e pesë milionë e katërqind e dyzet mijë e dyzet e tetë Lekë), me kushtin që kjo hua të kalojë në kapital të shoqërisë "ISOTECK ITALBA" shpk, si kontribut në para i shoqërisë tregëtare "E M A N T E" shpk. Kjo HUA është dhënë gjatë periudhës 2018-2019 dhe pasqyrohet si e tillë edhe në bilancin e shoqërisë "E M A N T E" shpk në aktive edhe në bilancin e shoqërisë "ISOTECK ITALBA" shpk në pasive.—

Pra, PALA I-rë në njohje të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë, (përmes përfaqësuesit të saj Ligjor/Administratorit) deklaron se sipas marrëveshjes së arritur me PALËN e II-të jashtë kësaj zyre, ka rënë dakord që të transferojë:

•Ndërtesë Industriale për Fabrikë Prodhimi e Panele Sandwich me sipërfaqe 4.749m² (katër mijë e shtatëqind e dyzet e nëntë metra katrorë) në vlerën 134.816.740 All (njëqind e tridhjetë e katër milionë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e dyzet Lekë) e cila do të kalojë në asetë të shoqërisë "ISOTECK ITALBA" shpk.


•Pasurinë e sipërcituar Truallin në vlerën 29.609.800 All (njëzet e nëntë milionë e gjashtëqind e nëntë mijë e tetëqind Lekë) e cila do të kalojë në kapitalin e shoqërisë "ISOTECK ITALBA" shpk si kontribut në natyrë i shoqërisë "E M A N T E" shpk.

•Huanë në vlerën 125.440.048 All (njëqind e njëzet e pesë milionë e katërqind e dyzet mijë e dyzet e tetë lekë), e cila do të kalojë në kapitalin e shoqërisë "ISOTECK ITALBA" shpk si kontribut në para i shoqërisë "E M A N T E" shpk.—

Sipas marrëveshjes së arritur jashtë kësaj zyre, PALA I-rë deklaron se këto asetë- ajo ja transferon shoqërisë "ISOTECK ITALBA" shpk e përfaqësuar në këtë akt nga Administratorët Z. HEKURAN BRAHIMAJ dhe Z.FRANCESCO GENTILE.—

Me nënshkrimin e këtij akti noterial, PALA II-të, shoqëria "ISOTECK ITALBA" shpk, bëhet pronare e këtyre asetë, të cilat pjesërisht (Toka dhe Huaja) do t'i shtohen kapitalit dhe për të cilat, ka të drejtë ta rregjistrojë sipas ligjit.—

Me nënshkrimin e kësaj kontrate PALA I-rë shoqëria "E M A N T E" shpk zhvishet pjesërisht nga pronësia mbi këto asetë sipas vlerave të mësipërme duke i hequr nga aktivet e saj por ky transferim nuk ndikon në kapitalin e shoqërisë pasi nuk janë të përfshira në kapital dhe nuk ndikojnë në objektin e veprimtarisë së shoqërisë "E M A N T E" shpk. Ato

 3

shtohen si asete të shoqërisë pjesa e ndërtesës kurse pjesa e tokës dhe e huasë do të kalojnë si kontribute në natyrë dhe në para i shoqërisë "E M A N T E" shpk tek Shoqëria "ISOTECK ITALBA" shpk.

Edhe shoqëria "ISOTECK ITALBA" shpk, përmes Administratorëve të saj Z. HEKURAN BRAHIMAJ dhe Z. FRANCESCO GENTILE deklarojnë se pranojnë transferimin e një pjese të aktivitetit/veprimtarisë "Prodhim Panele Sanduiç" të shoqërisë "E M A N T E" shpk në kushtet që ata kanë caktuar në marrëveshje të përbashkët.—

Me hartimin dhe noterizimin e kësaj kontrate PALA I-rë e humbet të drejtën e pronësisë dhe pronar i vetëm bëhet PALA II-të, shoqëria "ISOTECK ITALBA" sh.p.k përfaqësuar nga Administratorët Z. HEKURAN BRAHIMAJ dhe Z. FRANCESCO GENTILE.—

PALA I-rë deklaron se mban çdo përgjegjësi për saktësinë e dokumentave të sipërcituara.—

Për të vërtetuar sa më sipër, u hartua prej meje Noterit kjo Kontratë me transferim të aktivitetit, e cila pasi u lexua dhe u gjet sipas vullnetit të palëve kontratuese, u nënshkrua prej tyre në praninë time dhe unë Noteri e vërtetoj atë rregullisht.—

PALA I:

Shoqëria "E M A N T E" shpk
përfaqësohet nga Administratorja
Znj. FLUTURA BRAHIMAJ

Flutura Brahimaj



PALA II:

Shoqëria "ISOTECK ITALBA" shpk
përfaqësohet nga Administratorët

Z. HEKURAN BRAHIMAJ

Hekurani Brahimaj



Z. FRANCESCO GENTILE

Francesco Gentile

Përkthyesja e licensuar

Znj. VJOLLCA META

Vjollca Meta

NOTER
SOKOL SH. MALAJ



Sokol Sh. Malaj